

Komuna e Ferizajt/Uroševac

Nazmi (Xhemshir) Ukësmajli

(5.02.1975, shqiptar nga Jezerci/Jezerce, komuna e Ferizajt/Uroševac, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Nazmu i ka vijuar trajnimet ushtarake në Shqipëri dhe pas tyre u bë anëtar i shtabit lokal të UÇK-së në fshatin Jezerc/Jezerce. Në datën **16.07.1998**, pak pas mesnate, një grup pjesëtarësh të UÇK-së, në mesin e të cilëve ishte edhe Nazmiu, me dy makina të tipit *Lada Niva* u ndeshën me një patrullë të policisë serbe në Ferizaj/Uroševac te vendi i quajtur *Bashkimi i Lumenjve/Sastav reka*, në rrugë **Nerodime e Epërme/Gornje Nerodimlje - Jezerc/Jezerce**. Nazmiu ka gjetur vdekjen gjatë shkëmbimit të zjarrit në mes të dy palëve. Pas kryerjes së obduksionit në Institutin për Mjekësinë Ligjore, familjarët e kanë marrë trupin e Nazmiut dhe e kanë varrosur më 20.07.1998 në fshatin Jezerc/Jezerce. Pas përfundimit të luftës, më 12.09.1999, mbetjet mortore të Nazmitu u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Ferizaj/Uroševac.

Burimet: N. Krasniqi, *Kohë...*, 267-268; fotografija, FDH-19114; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMDLNJ, *Lista e civilëve...*, FDH-13491; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.52, FDH-30993; *Serb Police Shoots Dead 30-Year-Old Albanian in Ferizaj*, pasqyra e lajmeve, KIC, 17.07.1998, FDH-29365, KIC, I, 45.

Veselin (Stanimir) Lazić

(6.09.1951, serb nga Nerodimja e Epërme/Gornje Nerodimlje, komuna e Ferizajt/Uroševac, vozitës, tetë fëmijë)

Siniša (Bogdan) Lukić

(25.03.1963, serb nga Nerodimja e Epërme/Gornje Nerodimlje, komuna e Ferizajt/Uroševac, elektroteknik, dy fëmijë)

Siniša ka qenë elektrikist dhe ka jetuar në Nerodime të Epërme/Gornje Nerodimlje. Bashkëshortja dhe dy vajzat i jetonin në Slloveni. Veselini ka qenë shofer autobusi në linjën për në Jezerc/Jezerce. Në datën **19.07.1998**, Siniša me tre miq u nisën në pishinë në fshatin **Jezerc/Jezerce**. Rrugës e sipër, e morën me vete edhe Veselinin i cili ishte nisur në gjueti, si dhe vëllain e tij, i cili po ashtu shkonte në pishinë. E kanë parkuar makinën te ura në afërsi të vendit të quajtur *Bashkimi i Lumenjve/Sastav reka*. Veselini shkoi në pyllin e afërt, ndërkaq Siniša me burrat e tjerë në pishinë, ku gjendeshin afro njëzet persona, në mesin e të cilëve kishte edhe shqiptarë edhe serbë. Nga ai çast, Veselinin i humbet çdo gjurmë. Pas afro 45 minutash, Siniša dhe miqtë e tij vërejtën se nga drejtimi i Jezercit/Jezerce po afrohej një makinë – kabriolet [me kulm të hapur]. Vozitësi i saj ishte në uniformë, e kishte një jelek të zi, ndërkaq në dorën e majtë e mbante pushkën automatike. Pranë tij gjendej një burrë tjetër, po ashtu në uniformë. U ndalën pranë urës, ku Sinisha me miqtë e kishin parkuar makinën e vet. I pyetën diçka fëmijët që aty pranë shitnin çaj të malit. Pastaj, burra të armatosur e zunë pozicionin prapa makinës së Sinišës dhe filluan të shtënin në drejtim të vendit ku ishin Siniša me miqtë. Një mik i Sinišës, i cili e mbante revolen, e ktheu zjarrin. Siniša ka qenë i bindur se bëhej fjalë për serbë dhe u bërtiti në serbisht “mos gju-